



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:287041

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747180

KPPP.nr. 2211/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rr. "UÇK", nr. 2, kundër debitorit "Global Pharmaceuticals" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811255513 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Behar Begolli", p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 445/23 të datës 17.08.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Global Pharmaceuticals" Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 445/23 të datës 17.08.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 445/23, të datës 17.08.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve; Faturës nr. 201912709, e datës 19.12.2022, duke detyruar debitorin "Global Pharmaceuticals" Sh.P.K., që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 1,500.00 EUR (me shkronja: një mijë e pesëqind euro), si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetim se për shkak të problemeve financiare nuk është duke funksionuar dhe sa i përket faturës në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor, të njëjtën nuk e ka pranuar asnjëherë. I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin përbarimor.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit për arsye se asnjëra prej tyre nuk paraqet bazë për kundërshtim sipas nenit 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se lidhur me pretendimin e debitorit se janë plotësuar kushtet nga neni 61, par. 1.1 të LPP-së për të goditur urdhrin përmbarimor, e ka njoftuar gjykatën se dokumenti përmbarues i nxjerrë në procedurë administrative/kundërvajtje, në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave me të cilat rregullohet kjo procedurë. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti Faturë nr. 201912709 e datës 19.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se fatura e lartcekur nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme i’ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilës Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2211/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.